


Mbikëqyrja, principet, rregullat dhe procedurat

Cfare eshte Oversight ose Mbikqyrja

- Mbikëqyrja është një funksion kyç i MKV-s.
- Një sërë aktivitetesth të koordinuara për të mbështetur dhe për të siguruar që aktivitetet e grantit janë zbatuar ashtu siç janë planifikuar, dhe janë identifikuar dhe zgjidhur çështjet e pengesat në zbatimin e granteve.
- Mbikëqyrja nga MKV-ja vjen **si një kërkesë minimale e drejtë** (Kërkesa 3, sipas Udhëzime dhe Kërkesa për MKV-n) për pranimin e financimit nga Fondi Global.



Qellimi i ngritjes se Komitetit Mbikqyres

Komiteti Mbikëqyrës është përgjegjës për të kontribuar në mbikëqyrjen efektive të të gjitha programeve të financuara nga Fondi Global dhe proceseve të ngjashme në Shqipëri, në përputhje me funksionet e deleguara asaj nga MKV-ja e Shqipërisë për Fondin Global.

Komiteti ndihmon MKV-n për përmbushjen e përgjegjësisë së tij, për ta mbajtur Përfituesi/t Kryesor të përgjegjshëm ndaj burimeve të dhëna për vendin:

"Komiteti është i nevojshëm për të vënë në vend dhe për të ruajtur një proces transparent, të dokumentuar për të mbikëqyrur zbatimin e programit"

Kerkese nga GF

- ❑ Prezantim dhe zbatim i *planit te mbikqyrjes* për të gjitha financimet e miratuara nga Fondi Global..
- ❑ Aktivitetet e planit të mbikëqyrjes duhet të detajohen me hollësi, dhe duhet të përshkruajnë mënyrën se si MKV-ja do të angazhohet, aktorët e programit të mbikëqyrjes, duke përfshirë anëtarë dhe jo-anëtarë të MKV-s, dhe në veçanti grupimet jo-qeveritare dhe njerëzit që jetojnë me dhe / ose të prekur nga sëmundjet".



**Gathering
Informati
on**



**Analyzing
Information
to Identify ...**

- problems
- bottlenecks
- successes



**Recommending
action
to resolve ...**

- problems
- bottlenecks



**Monitoring
Action
and
Reporting
on results**

Parimet e mbikëqyrjes së MKV-s

- ✚ Përgjegjësia e mbikëqyrjes është thelbësore për të zbutur rreziqet, për të kapërcyer pengesat dhe për të rritur transparencën në lidhje me dhënien dhe zbatimin e granteve.
- ✚ **Nëpërmjet mbikëqyrjes së MKV-s**, Perfituesi Kryesor mban përgjegjësi për të gjitha grupet e interesit të vendit.

Mbikqyrja vs. Monitorim & Vleresimit.

- Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të përqëndrohen në aktivitetet e detajuara të zbatimit të programit, të cilat janë përgjegjësi e Përfituesit Kryesor dhe Agjencive të tjera zbatuese.
- Mbikqyrja është një "panoramë e madhe" e zbatimit të grantit. Ajo heton të gjithë grantin për të identifikuar çështjet ndërsektoriale, dhe theksi vihet në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve të rrezikshme për suksesin e granteve.

Ku fokusohet mbikqyrja?

- Ku janë parat?
- Ku janë ilaçet, furnizimet mjekësore dhe pajisjet?
- A po marrin Nën-Kontraktuesit burimet e kërkuara dhe asistencë teknike siç është planifikuar?
- A janë duke u zbatuar grantet sikurse janë planifikuar?
- Cilat janë pengesat për zbatimin e grantit dhe se si mund të zgjidhen ato?
- A është i nevojshëm riprogramimi i aktiviteteve për të plotësuar nevojat e zhvillimit në vendit?
- A janë rezultatet në përputhje me objektivat e performancës?

"MKV-ja mbikëqyr performancën e Përfituesit/ve për të siguruar që ata do të arrijnë objektivat e programeve të rëna dakord dhe janë në zbatim.

Nëpërmjet MKV mbikëqyret PK që mban përgjegjësi për të gjitha palët e interesit të vendit. "

Standardet e Mbikëqyrjes

- MKV-ja duhet të sigurojnë që programi i aktiviteteve të kontribuojë në **eliminimin e stigmatizimit dhe të diskriminimit** ndaj atyre që jetojnë me HIV /TB dhe të prekur nga këto sëmundje, veçanërisht popullata që janë të marginalizuar ose të kriminalizuar.
- Çdo MKV **duhet të ketë një strategji të komunikimit** të dakordsuar me PK të saj, duke detajuar aktivitetet e komunikimit gjatë gjithë ciklit jetësor të granteve, dhe duke përfshirë përditësime të planifikuara financiare dhe programore për MKV për performancën e PK dhe NK.

E rëndesishme!

Mbikëqyrja është përgjegjësi kryesor e MKV-s.

Si rrjedhojë, të gjithë anëtarët MKV-se kanë përgjegjësi për të marrë pjesë në mbështetjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes.

Për të lehtësuar punën efektive të këtij roli, MKV-ja ka themeluar një Komitet Mbikëqyrës "për të diskutuar dhe për të bërë rekomandime për të gjitha çështjet e mbikëqyrjes në përputhje me Termat e Referencës dhe planin e vet të punës, apo për çdo çështje që i referohen atij nga MKV-ja e Shqipërisë.

Përgjegjësitë e përgjithshme.

Komiteti Mbikëqyrës i MKV-s është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen për grantet ekzistuese të Fondit Global në Shqipëri në tri fusha:

- **Financiar** – për të siguruar përdorimin e duhur, në kohë dhe efektiv të fondeve nga Fondi Global;
- **Programatik** – për të siguruar zbatimin në kohë dhe efektiv të planeve të punës të PK dhe NK;
- **Performance** – për të siguruar arritjen e rezultateve të synuara në periudha afatshkurtra të ndërmjetme dhe afatgjata.

Pergjegjesi !

- Komiteti Mbikëqyrës është i autorizuar të diskutojë dhe të bëjë **rekomandime** për të gjitha çështjet e mbikëqyrjes në përputhje me Termat e Referimi dhe të planit të saj të punës, apo për çdo çështje që i referohet atij nga MKV-ja e Shqipërisë.
- Pas hartimit të rekomandimeve Komiteti Mbikëqyrës duhet të paraqesë të gjitha rekomandimet në mbledhjen e ardhshme të MKV-s Shqipërisë.
- Në konsultim me MKV-n e Shqipërisë, Komisioni për Mbikëqyrjen duhet të udhëheq ose të kontribuojnë në proceset e mëposhtme të mbikëqyrjes:
 - a. Zbatimin e Grantit;
 - b. Rishikimet periodike
 - c. Vlerësimin e mbylljes së Grantit;
 - d. Koordinimin e donatorëve dhe delegimin me sistemet shëndetësore;
 - e. Mbylljen e Grantit.

Pergjegjesi !

Komiteti Mbikëqyrës duhet të sigurojë kryerjen e funksioneve të tij mbikëqyrëse në lidhje me fushat e mëposhtme të programeve të financimit dhe aktiviteteve të Fondit Global në Shqipëri:

- a. Financave, përfshirë përjashtimit nga taksat,
- b. Menaxhimit të Grantit nga ana e PK;
- c. Prokurimit;
- d. Zbatimit ;
- e. Partneritetit PK / NK;
- f. Rezultateve;
- g. Raportimit;
- h. Asistencës teknike.

Kur vepron mbikqyrja?

Përgjegjësite janë ne të gjitha fushat e zbatimit të grantit:

- Në të gjitha fazat / hapat e zbatimit;
- Ndryshime të mëdha në grante, duke përfshirë ndryshimet në objektivat e punës, strukturën e treguesve të performancës së grantit, riprogramimin dhe ndryshimet në përcaktimin e partnerëve të zbatimit;
- Mbylljen e Grantit, duke përfshirë rishikimin dhe miratimin e ndonjë plani të mbylljes/çlirimit(p.sh., shpërndarjen dhe asgjësimin e aseteve të programit) dhe buxheteve.

Anëtarësia

- Komiteti Mbikëqyrës duhet të përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të zakonshëm të emëruar nga MKV-ja.
- Anëtarësia e MKV-s nuk është një parakusht për anëtarësimin në Komitetin Mbikëqyrës, me përjashtim të pozicionit të Kryetarit dhe Zëvendës/Kryetarit të Komitetit Mbikëqyrës.
- Anëtarët e Komitetit Mbikëqyrës nuk duhet të jenë përfaqësues të Përfituesit/ve Kryesor, apo Nën-përfituesve.
- Komiteti Mbikëqyrës duhet të ketë një anëtar me ekspertizë në Menaxhim Financiar.

Anëtarësia (vazhdim)

- Komiteti Mbikëqyrës duhet të përbëhet nga Kryetari dhe Zv/kryetari dhe katër anëtarë të zakonshëm të emëruar nga MKV-ja.
- Anëtarësia e MKV-s nuk është një parakusht për anëtarësimin në Komitetin Mbikëqyrës, me përjashtim të pozicionit të Kryetarit dhe Zëvendës/Kryetarit të Komitetit Mbikëqyrës.
- Anëtarët e Komitetit Mbikëqyrës nuk duhet të jenë përfaqësues të Përfituesit/ve Kryesor, apo Nën-përfituesve.
- Komiteti Mbikëqyrës duhet të ketë një anëtar me ekspertizë në Menaxhim Financiar.

Ekspertiza dhe përvoja e Anëtarësisë.

- ✓ Zbatimit të ndërhyrjeve të programeve e HIV-AIDS, TB apo Forcimin e Sistemit Shëndetësor (FSS) në nivele kombëtar dhe / ose lokale.
- ✓ Finance ose kontabilitet në organizatat e mëdha / të mesme publike apo në sektorin privat.
- ✓ Përvojë pune me organizatat avokuese që përfaqësojnë njerëzit që jetojnë me, ose të prekur nga sëmundjet.
- ✓ Anëtarët duhet të kenë përvojë të konsiderueshme (p.sh., 8-10 vjet) në fushat përkatëse të ekspertizës.

Frekuenca e takimeve

Komiteti Mbikëqyrës duhet të mblidhet të paktën çdo tre muaj, ose me shpesh në rast se e kërkojnë rrethanat.

Mbledhjet do të mbahen të paktën 2 javë përpara çdo takimi të rregullt tremujor të MKV-s, në mënyrë që mbledhjet e Komitetit të mund të raportohen në MKV.

Rregullorja e punës:

1. Komiteti do të veprojë me shumicë të thjeshtë votash.
2. Kuorumi për mbledhjet do të jetë pesëdhjetë për qind të anëtarëve të saj.
3. Komiteti mblidhet të paktën çdo tre muaj dhe shpeshtësia e takimeve përcaktohet nga ana e anëtarëve të Komitetit në përputhje me përgjegjësitë e tij mbikëqyrëse (p.sh., ciklet e raportimit PK axhendës së mbledhjeve të MKV, dhe çështje apo nevojave të tjera relevante të mbikëqyrjes).
4. Koha e takimeve do të përcaktohet nga Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës në konsultim me anëtarët e tjerë të Komitetit. Takimet do të zhvillohen të paktën 2 javë para çdo mbledhje të rregullt tremujore të MKV-s.

vazhdim

5. Çdo takim do të ketë një axhendë, e cila do të shpërndahet para Mbledhjes.
6. Kryetari do të drejtojë të gjitha mbledhjet e Komitetit Mbikëqyrës. Në rast se Kryetari nuk është në gjendje të marrë pjesë në një takim, do të drejtohet nga Zëvendës-Kryetari. Nëse të dy Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi mungojnë, dhe duke supozuar se kuorumi është i pranishëm, pjesëmarrësit e takimit do të caktojnë një Kryetar të përkohshëm. Kryetari i përkohshëm duhet të jetë një anëtar i MKV apo alternativë.
7. Në çdo mbledhje të komitetit, me mbështetjen e Sekretariatit, Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës, do të jetë përgjegjës për hartimin e një axhende.
8. Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës, me mbështetjen e Sekretariatit, do të jetë përgjegjës për të siguruar që rendi i ditës dhe çdo dokument ose informacionet e tjera që kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës u shpërndahen anëtarëve të komisionit jo më pak se dy javë para datës së caktuar të mbledhjes.

vazhdim

9. Procesverbali, duke përfshirë listën e të pranishmëve, do të përgatiten për çdo mbledhje dhe arkivohen nga Sekretariati. Procesverbalet e të gjitha takimeve të Komitetit Mbikëqyrës do të shtrohet në takimet e MKV-s.

10. Raportin me diskutimet dhe rekomandimet e tij, Komiteti Mbikëqyrës do ta paraqesë në Mbledhjen e radhës së MKV-s.

11. Sekretariati i MKV-s do ti ofrojë asistencën e nevojshme Komitetit Mbikëqyrës të tilla si mbajtja e minutave, mbështetja logjistike për aktivitetet mbikëqyrëse dhe çështje të tjera administrative.

12. Komiteti Mbikëqyrës për të pasuruar rrahjet e mendimeve mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhjet e tij, përfaqësues të KP dhe NK dhe partnerë të tjerë implementues e palët e interesuara, në funksion të dhënies së informacionit, komenteve, dhe ekspertizës.

Parimet udhëheqese te MKV

- Qëllimi suprem i MKV-s është që ti shërbejë interesit të publikut;
- Aktivitetet e MKV-s duhet të promovojnë transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin e MKV-s;
- Ndërtimi i besimit të publikut është një gur themeli për qeverisjen e mirë;
- Promovimi i përgjegjësisë organizative dhe individuale për çdo anëtar të MKV-s duhet të zhvillohet përmes shembullit;
- Promovimi i një kulture që është intolerante ndaj konflikteve aktuale apo të perceptuara të interesit duhet të udhëheqë MKV-n në aktivitetet e saj;
- Konfliktet e interesit duhet të menaxhohen përmes politikave dhe procedurave formale;

Perkufizimi I konfliktit te interesit

Konflikt interesi kemi në rastet kur një anëtar i MKV-s ose Sekretariati i MKV-s *përdor pozitën e tij / saj për të çuar përpara ambiciet apo interesat personale, interesat e një institucioni me të cilin ai / ajo është i lidhur, të një anëtari të familjes, ose bashkëpunëtori të ngushtë*, në një mënyrë që të disavantazhojë ose përjashtojë të tjerët, ose është i vendosur të dëmtojë efikasitetin e përgjithshëm të programit.

KI i mundshem dhe i perceptuar!

Një konflikt **i mundshëm** i interesit ndodhe atëherë kur një anëtar i MKV-s ose Sekretariati i MKV-s është vendosur në një pozitë të tillë, në të cilën ka kapacitet për të përdorur pozitën e tij / saj ose të statusit, siç përcaktohet më lart, për tu gjendur në një konflikt interesi.

Një konflikt **i perceptuar** i interesit ndodh atëherë kur një person beson apo ka dyshime mbi baza të arsyeshme se një konflikt i interesit, siç përcaktohet më lart, ekziston nga ana e një anëtari të MKV-s ose Sekretariati i MKV-s.

Konfliktet e interesit mund të lindin ne rastet:

Përzgjedhjes së Përfituesit/ve Kryesorë dhe Nën-përfituesve;

Kërkesave të ripërtëritjes për një fazë të ardhshme të një granti;

Një riprogramimi të konsiderueshëm të fondeve të grantit;

Çështje që lidhen me vlerësimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e Përfituesit/ve Kryesorë dhe Nën-përfituesve;

Diskutimin e çështjeve në të cilat anëtarët e MKV-s apo institucionet e tyre kanë një interes financiar, të tilla si kontraktimi, rekrutimi i stafit etj.

Zbatimi i Politikës së Konfliktit të Interesit !

- Konflikti i politikës së interesit aplikohet për anëtarët MKV, zëvendësit dhe stafin e Sekretariatit të MKV-s.
- MKV-ja do të sigurojë që për marrjen e vendit dhe të paktën një herë çdo vit, anëtarët e MKV ti nënshtrohen orientimit mbi përgjegjësitë e tyre në lidhje me konfliktin e interesave dhe kërkesave të kësaj politike.
- MKV-ja delegon Komitetin Ekzekutiv si Autoritet i MKV-s për të adresuar etikën dhe konfliktin e çështjeve të interesit
- MKV-ja duhet të marrë parasysh pasojat e konfliktit të interesit në përbërjen e tij, kur konsideron rinovimin e anëtarësimit.

